

Informacion i rëndësishëm për Prindërit

Truri i fëmijës/adoleshentëve tuaj dhe Përdorimi i Substancave - Alkool, Marihuanë, Duhan dhe Droga të Tjera



Truri i fëmijës/adoleshentit tuaj vazhdon të zhvillohet deri ne mesin e viteve 20.



Hulumtimet shkencore kanë zbuluar se përdorimi i alkoolit, marihuanës dhe duhanit mund të ketë shumë efekte negative në zhvillim e trurit dhe mund të rezultojë në dëme gjatë gjithë jetës.



Hulumtimet na tregojnë se këto substanca mund të dëmtojnë zonat e trurit, duke përfshirë korteksin parabollo, i cili është i rëndësishëm për vendimmarrjen dhe zgjidhjen e problemeve.

Efektet e përdorimit të alkoolit, marihuanës, duhanit dhe drogave të tjera në zhvillimin e trurit të adoleshentëve mund të përfshijnë:

- Probleme me kujtesën dhe të mësuarit, duke rezultuar në më pak sukses në shkollë dhe në jetë.
- Problemet e shëndetit mendor, duke përfshirë ankthin, depresionin dhe mundësinë për vetëvrasje. (Adoleshentët shpesh mendojnë se përdorimi i substancave ndihmon në uljen e stresit, por në fakt mund ta rrisë atë.)
- Pamundësia për të menaxhuar emocionet dhe për t'u sjellë siç duhet
- Zhvillimi i problemeve shëndetësore të të rriturve, p.sh. sëmundje të zemrës dhe mushkërive, tension të lartë të gjakut
- Varësia. Kur adoleshentët fillojnë të pinë dhe/ose të përdorin marihuanë, duhan ose droga të tjera, ekziston një rrezik shumë më i madh i varësisë sesa kur përdorimi fillon në moshën e rritur.



PRINDËR! FLISNI SHPESH ME FËMIJËT/ADOLESHENTET TUAJ PËR RREZIQET E PËRDORIMIT TË ALKOOLIT, MARIHUANËS, DUHANIT DHE DROGAVE TË TJERA.

Biseda me ta bën që fëmijët/adoleshentët tuaj të kuptojnë më shumë rreziqet dhe të mos përdorin substanca të dëmshme.

Informacion nga Instituti Kombëtar për Abuzimin me Drogën. <https://nida.nih.gov>



Koalicioni
Chippewa Valley për të
Rinjtë dhe Familjet

www.cvcoalition.org